

Eksploroni shpellat e Parkut Natyror Rajonal SHKREL

Explore the caves of the Shkrel Regional Nature Park

The Shkrel Regional Nature Park offers a beautiful panorama from the chestnut forest of Reç to the high mountain of Bogë, passing by the Razma forest. This park is also giving you the opportunity to discover the underground world, with many caves that can be visited by beginners and experts.

Parku Natyror Rajonal Shkrel ofron një peizazh të mrekullueshëm nga pylli i gështenjave në Reç në bjeshkët e Bogës, duke kaluar përmes pyllit të Razmës. Ky park ju jep gjithashtu mundësinë për të zbuluar botën nën tokësore, të pasur me shumë shpella, që mund të vizitohen nga fillestarë dhe ekspertë.



Many amazing trails are leading you to the caves of the area, with the best views on the Shkodra lake, Canyons, Bogë valley or Montenegro.

Shumë shtigje të mahnitshme ju shpien në shpellat që gjenden në zonë, me pamjet më të bukura nga liqeni i Shkodrës, Kanionet, lugina e Bogës ose Mali i Zi.




No need to be an expert to discover the amazing underground treasures of Shkrelit! Many caves are easily accessible for everyone. However, keep in mind that to enjoy it at the maximum, the security must be the priority!

Nuk është nevoja të jeni ekspertë për të zbuluar thesaret e mrekullueshme të nëntokës së Shkrelit! Shumë shpella janë lehtësisht të aksesueshme për çdokënd. Megjithatë, kini parasysh se për t'i shijuar ato në maksimum, siguria duhet të jetë përparësi!

The Shkrel Regional Nature Park is the perfect place to discover and learn how to explore caves in a safe way! Take part of training in easy caves before trying a more challenging 40 meters deep cave.

Parku Natyror Rajonal Shkrel është vendi i përkryer për të zbuluar dhe mësuar si të eksploroni shpella në një mënyrë të sigurtë! Eksploroni dhe aftësohuni së pari në shpella të lehta para se të provoni të eksploroni ato që janë më sfiduese, prej 40 metrash të thella.



In addition of being geological treasures, caves are hosting an important but fragile biodiversity. Visiting a cave can be a fantastic experience, but if some rules are not respected, it can strongly impact the rare and important cave biodiversity.

In order to avoid bats disturbance, it is recommended to follow during all the year, these few rules:



- Do not catch, or try to catch bats!



- Avoid noises in front and inside the cave!



- Avoid strong light on bats!

- Visit caves in small groups!

- If important number of bats, avoid to visit the cave!

Bats, as well as stalactite and stalagmites, are very sensitive to disturbance and movement inside the cave. The bats are very useful for humans, as natural insect regulator and are protected species.



Përveçse janë thesare gjeologjike, shpellat kanë në brendësi të tyre një biodiversitet të rëndësishëm, por të brishtë. Eksplorimi i një shpelle mund të jetë një përvojë e mrekullueshme, por nëse nuk respektohen rregullat, mund të ndikojë negativisht në biodiversitetin e rëndësishëm dhe të rrallë të shpellës.

Në mënyrë që të shmangim shqetësimin e lakuriqëve të natës, është e rëndësishme të ndiqen disa rregulla:



• Mos i kapni, ose të përpiqeni të kapni lakuriqët e natës.



• Shmangni zhurmat përballë dhe brenda në shpellë.



• Shmangni dritat e forta ndaj lakuriqëve të natës.

• Eksploroni shpellën në grupe të vogla.

• Nëse ka numër të lartë të lakuriqëve të natës, shmangni eksplorimin e shpellës.

Lakuriqët e natës, si edhe stalaktitet dhe stalagmitet, janë shumë të ndjeshëm ndaj zhurmave dhe lëvizjeve në shpellë. Lakuriqët e natës (specie të mbrojtura) janë aspak të rrezikshëm për njerëzit dhe shumë të rëndësishëm për insektet.



The most beautiful caves in the Shkrel Regional Nature Park are: Shpella e Madhe in Bogë, Shpella e Pëllumbave and Shpella e Shtogut in Razma, Shpella e Gurrës in Reç. These amazing caves and other caves in the area must be visited in the presence of local guides: for your safety and to safeguard their biodiversity.

Shpellat më të bukura në Parkun Natyror Rajonal Shkrel janë: Shpella e Madhe në Bogë, Shpella e Pëllumbave dhe Shpella e Shtogut në Razëm, Shpella e Gurrës në Reç. Këto shpella me bukuri të veçantë apo shpella të tjera në zonë, duhen vizituar patjetër në praninë e udhërrëfyesve vendas: për sigurinë tuaj dhe për të ruajtur biodiversitetin e tyre.

SHPELLA E MADHE

Bogë



The cave has an entrance of 40m, is 15m deep and is 5m high at the maximum. Historical artefacts (around 300 years old) have been discovered inside the cave. This cave is believed to be one of the first place use by the first inhabitants of the valley. The cave is directly connecting with a trail and the panorama from the cave is offering the view on the complete valley, while the cave is just 10min walking for the road.

Shpella ka një hyrje prej 40m, është 15m e thellë dhe 5m e lartë në maksimum. Objekte historike (rreth 300 vjeçare) janë zbuluar brenda kësaj shpelle. Kjo shpellë besohet të jetë një nga vendet e para të përdorura nga banorët e parë të luginës. Shpella lidhet direkt me një shteg. Panorama që shihet nga shpella e lejon personin që të ketë një pamje të plotë të luginës. Shpella ndodhet vetëm 10 min në këmbë nga rruga.



SHPELLA E PËLLUMBAVE

Razëm

The cave is 30m deep and is 20m high at the maximum. Interesting light effect can be seen inside the cave, thanks to an important opening. Stairs in wood allow the public to enter in the cave.

Shpella është 30m thellë dhe 20m e lartë në maksimum. Efekte interesante drite mund të shihen brenda shpellës, falë një hapjeje të rëndësishme. Shkallët prej druri lejojnë publikun të hyjë në këtë shpellë.

SHPELLA E SHTOGUT

Razëm

The cave is 20m deep and is 13m high at the maximum. Interesting geological forms can be observed inside this cave.

Shpella është 20m thellë dhe është 13m e lartë në maksimum. Forma interesante gjeologjike mund të shihen brenda kësaj shpelle.



SHPELLA E GURRËS

Reç


The cave is composed by several rooms and a main corridor made by humans. After 20m, this corridor is reaching a natural cave with numerous geological features. After 20m the cave is vertical (40m) with water at the bottom.

Shpella përbëhet nga disa dhoma dhe nga një korridor kryesor i bërë nga njerëzit. Pas 20m, ky korridor arrin një shpellë natyrale me karakteristika të shumta gjeologjike. Pas 20m shpella është vertikale (40m) me ujë në fund.



Map of Caves in the Regional Nature Park Shkrel

Harta e Shpellave në Parkun Natyror Rajonal Shkrel



Cave/Shpella

- Shpella e Gurrës 2
- Shpella e Bogdanave
- Shpella e Lopve
- Shpella e Gurrës
- Shpella e Straxhes
- Shpella e Shtogur
- Shpella e Majës Kryqaz
- Shpella e Pëllumbave
- Shpella e Gerebemit me ujë
- Shpella e Dhenve
- Shpella e Lujstit
- Shpella e Hoxhës
- Shpella e Teneqes
- Shpella e Zanave
- Shpella e Mullinit
- Shpella e Madhe



If you want to have the best experience possible with the caves in Shkrel, contact for more information and guided tours:

Nëse dëshironi të përjetoni përvojën më të mirë të eksplorimit të shpellave në Shkrel, për më shumë informacion ose për ture me udhërrëfyes, kontaktoni:

Tourist Information Office in Dedaj
Municipality of Malësi e Madhe
Zyrën e Informacionit Turistik në Dedaj
Bashkia Malësi e Madhe

Mob. +355 674113458 / njësiashkrel@gmail.com
Mob. +355 684575666 / info@kelmend-shkrel.org
www.kelmend-shkrel.org
fb: Kelmend-Shkrel & VIS Shkrel

This promotional brochure has been published thanks to the financial contribution of the Italian Agency for Development Cooperation in the frame of the project "Buke, Kripe e Zemer"

Kjo broshurë promovuese u mundësua falë kontributit financiar të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim, në kuadër të projektit "Bukë, Kripë e Zemër"

Text /Teksti: Philippe Théou
Pictures by/Fotot nga: Philippe Théou & VIS Albania

